



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostiguar Prilbjenol/Prodato Received/Delivery	14.04	702	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	3610/2023		1/3	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.435/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.435/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.435/2023 e datës 01.03.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën “ Zyrtare e Prokurimit” në Departamentin e Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Akt Emërimit me referencë: 158/PRK2 të datës 29.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2205/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Njoftimit për shpallje të Konkursit për dy pozita Zëvendës Drejtor Menaxhues Funksione Mbështetëse dhe Zëvendës Drejtor Menaxhues Operativë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.03.2023 me numër protokoli 2701/2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa Këshilli më datë 28.03.2023, me numër protokoli 3082/2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, me shkresat e bashkangjitura.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 2205/2023 të datës 01.03.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga PAK INFO për PAK ALL i datës 15.02.2023; Konkurs Pranim i mbyllur në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me nr. Reference RN00010969 i datës 13.02.2023; Konkurs Pranim i mbyllur në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me nr. Reference RN00010838 i datës 13.02.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoli 2701/2023 i datës 15.03.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokoli 3082/2023 i datës 28.03.2023; Vendim me numër Nr.Ref.BD-174-3 i datës 23.12.2022; E-mail nga D.GJ. për L.Xh.T. i datës 24.03.2023; E-mail nga L.Xh.T. për D.GJ. i datës 02.03.2023; E-mail nga D.GJ. për D.GJ. etj. i datës 01.03.2023; E-mail nga D.GJ. për L.Xh.T. i datës 01.03.2023; E-mail nga L.Xh.T. për D.GJ. i datës 01.03.2023; E-mail nga D.GJ. për L.Xh.T. i datës 28.02.2023; E-mail nga L.Xh.T. për D.GJ. i datës 23.02.2023; E-mail nga A.L.G. për HR@pak-ks.org i datës 23.02.2023; E-mail nga D.GJ. për A.L.G. i datës 23.02.2023; E-mail nga A.L.G. për D.GJ. i datës 23.02.2023; E-mail nga D.GJ. për A.L.G. etj. i datës 23.02.2023; Akt Emërim i D.GJ. me referencë 158/PRK2 i datës 29.02.2022; Detyrat e të emëruarit; Përshkrimi i punës për pozitën Zyrtar i Prokurimit;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesja është e punësuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Akt Emërimit me referencë 158/PRK2 të datës 29.02.2022 në pozitën e punës "Zyrtare e Prokurimit" në Departamentin e Prokurimit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj",* dhe me këtë rast konstaton se duke marrë parasysh faktin se ankuesja ankesën në Këshill e parashtron kundër Njoftimit konkretisht konkursit me numër të referencës RN00010969 të datës 13.02.2023, si dhe konkursit me numër të referencës RN00010838 të datës 13.02.2023 të shpallur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit lidhur me pozitën për Zëvendës Drejtor Menaxhues Funksione Mbështetëse dhe Zëvendës Drejtor Menaxhues Operativë, pa qenë kandidatë pjesëmarrëse në këtë procedurë të rekrutimit dhe pa përfunduar të gjitha fazat lidhur me të njëjtën, atëherë Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshill ende pa kaluar afati i përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative nga ana e organit të punësimit, kështu që në këtë kuptim ankesa e ankueses është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafit 1 dhe nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, konstaton se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas*

shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative, si dhe duke ju referuar nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil. Poashtu Rregullorja (QRK) 16/2020 për pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës Kosovës në nenin 31 paragrafin 1 dhe 2 përcakton se: 1. Kandidati në procedurën e pranimin në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshill ende pa kaluar afati i përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative nga ana e organit të punësimit, kështu që ankesa e ankueses është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafi 1 dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.435/2023

Çlirim ZEKA

  
Procesmbajtës



### Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.